



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 4, Datë 21.07.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR “NDËRTIMIN E RRUGËS “QUKËS – QAFË PLOÇË” ME VENDNDODHJE NË QARKUN ELBASAN DHE NË QARKUN KORÇË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, nenit 19 të Vendimit nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, VKM-së nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Ndërtimin e Rrugës “Qukës - Qafë Ploçë”, me vendndodhje në Qarkun Elbasan dhe Qarkun Korçë, me subjekt aplikues Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe kërkues Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturës bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njësive të Qeverisjes Vendore, ku shtrihet projekti.
5. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**


**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



*Edmond Haxhinasto*

**EDMOND HAXHINASTO**



**MINISTËR I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS**

**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GREÇA**

*Adelina Greça*



**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**